



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

**Politika për Kundërveprimin ndaj Ndërhyrjeve të Huaja të
Paligjshme dhe Dezinformimit si Kërcënime Hibride në
Republikën e Shqipërisë**

Përmbajtja

1. Qëllimi	3
2. Fusha e zbatimit.....	3
3. Parimet Themelore	3
4. Rolet dhe Përgjegjësitë	3
5. Elementët Kryesorë të Politikës	4
6. Bashkëpunimi Ndërkombëtar	4
7. Zhvillimi Ligjor dhe Mbikëqyrja.....	5
8. Zbatimi dhe Afatet (2025–2030)	5
9. Referencat.....	5
10. Frekuenca e Rishikimit.....	5

1. Qëllimi

Qëllimi i këtij politike është krijimi i një kuadri gjithëpërfshirës, të strukturuar dhe të zbatueshëm për parandalimin, zbulimin, identifikimin dhe reagimin ndaj ndërhyrjeve të huaja të paligjshme dhe dezinformimit si kërcënime hibride, duke mbrojtur institucionet demokratike, besimin publik dhe sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Politika synon të forcojë qëndrueshmërinë ligjore, institucionale dhe shoqërore, si dhe të sigurojë përputhje të plotë me praktikën më të mira të Bashkimit Evropian, NATO-s dhe partnerëve euroatlantikë.

2. Fusha e zbatimit

Kjo politikë zbatohet në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030 dhe ka për objekt adresimin e ndërhyrjeve të huaja të paligjshme, dezinformimit dhe operacioneve të ndikimit të mbështetura në mjete kibernetike, të cilat cenojnë sigurinë kombëtare, stabilitetin institucional dhe funksionimin demokratik të shtetit.

Fusha e zbatimit të politikës shtrihet mbi institucionet qendrore dhe të pavarura, duke përfshirë strukturat përgjegjëse për sigurinë, administratën publike dhe organet e pavarura kushtetuese. Ai mbulon gjithashtu proceset zgjedhore dhe demokratike, me qëllim garantimin e integritetit të tyre ndaj ndërhyrjeve dhe manipulimeve të jashtme.

Politika adreson në mënyrë të posaçme hapësirën informative dhe mediatike, duke synuar parandalimin dhe menaxhimin e fushatave të dezinformimit dhe operacioneve të ndikimit që shfrytëzojnë platformat digjitale dhe mjetet kibernetike. Një komponent i fushës së zbatimit është edhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, si mekanizëm i rëndësishëm për përballimin efektiv të kërcënimeve hibride me natyrë ndërkufitare.

3. Parimet Themelore

Zbatimi i kësaj politike mbështetet në respektimin e sovranitetit dhe rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë, duke garantuar mbrojtjen e pavarësisë institucionale dhe funksionimin demokratik të shtetit. Të gjitha masat e parashikuara ndërmerren në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe proporcionalitetit, duke siguruar që ndërhyrjet kundër kërcënimeve hibride të mos cenojnë lirinë e shprehjes, pluralizmin mediatik apo të drejtat themelore të njeriut. Politika promovon transparencën, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen demokratike, përmes rolit të institucioneve përkatëse dhe raportimit publik periodik. Një element i qasjes së tij është bashkëpunimi ndërqeveritar dhe shoqëror, i cili synon koordinimin ndërinstitucional dhe përfshirjen e aktorëve publikë, privatë dhe akademikë. Në të njëjtën kohë, politika siguron përputhje të plotë me standardet dhe politikën euroatlantike, duke harmonizuar veprimet kombëtare me kornizat e Bashkimit Evropian dhe NATO-s.

4. Rolet dhe Përgjegjësitë

Në kuadër të kësaj politike, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) ushtron një rol koordinues në adresimin e kërcënimeve hibride. AKSK vepron si autoriteti teknik kombëtar përgjegjës për identifikimin, analizën dhe menaxhimin e këtyre kërcënimeve, duke shërbyer njëkohësisht si qendër kombëtare koordinuese për zbulimin e hershëm, analizën e rrezikut dhe reagimin e koordinuar ndaj incidenteve. Në këtë kontekst, AKSK përfaqëson gjithashtu pikën kryesore të ndërlidhjes ndërkombëtare për bashkëpunimin teknik dhe operacional me partnerët rajonalë, evropianë dhe euroatlantikë.

Në ushtrimin e këtij roli, AKSK realizon vlerësime periodike kombëtare të riskut, zhvillon dhe ndan inteligjencë mbi kërcënimet hibride dhe operacionet e ndikimit, si dhe koordinon reagimin ndërinstitucional në rastet e incidenteve apo krizave hibride. Paralelisht, AKSK udhëheq proceset e ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe ofron këshillim strategjik për

institucionet shtetërore, me qëllim forcimin e qëndrueshmërisë kombëtare dhe përmirësimin e gatishmërisë përballë kërcënimeve komplekse.

Zbatimi efektiv i politikës mbështetet gjithashtu në një ndarje të qartë rolesh dhe përgjegjësisë ndërmjet institucioneve të tjera shtetërore. Këshilli i Ministrave siguron drejtimin strategjik dhe merr vendime në situata krize, duke garantuar koordinimin politik dhe institucional në nivel të lartë. Shërbimet e inteligjencës kontribuojnë me identifikimin dhe analizën e aktorëve të huaj, si dhe me vlerësime strategjike të mjedisit të sigurisë. Policia e Shtetit dhe organet e prokurorisë ushtrojnë kompetencat e tyre në hetimin dhe ndjekjen penale të veprave që lidhen me ndërhyrjet e huaja dhe aktivitetet e paligjshme.

Autoritetet zgjedhore kanë përgjegjësi të veçantë për mbrojtjen e integritetit të proceseve zgjedhore, në bashkëpunim të ngushtë me AKSK dhe institucionet e tjera përkatëse, veçanërisht gjatë periudhave zgjedhore. Autoritetet mediatike dhe rregullatore kontribuojnë në garantimin e standardeve të transparencës, pluralizmit dhe përgjegjshmërisë në hapësirën informative. Parlamenti, nëpërmjet mekanizmave të mbikëqyrjes demokratike dhe procesit legjislativ, siguron kontrollin institucional, llogaridhënien dhe përditësimin e kuadrit ligjor në përputhje me zhvillimin e kërcënimeve hibride.

5. Elementët Kryesorë të Politikës

Kjo politikë ndërtohet mbi një qasje të integruar që mbulon të gjithë ciklin e menaxhimit të kërcënimeve hibride. Ajo parashikon ngritjen e mekanizmave të qëndrueshëm për zbulimin dhe paralajmërimin e hershëm, përmes monitorimit kombëtar të kërcënimeve hibride dhe analizës së ndërlidhjes ndërmjet incidenteve kibernetike dhe fushatave të dezinformimit, duke shfrytëzuar analiza të avancuara dhe mjete të inteligjencës artificiale. Një komponent tjetër është identifikimi, i cili përfshin forensikën kibernetike, vlerësimin e operacioneve të ndikimit, si dhe integrimin e burimeve të ndryshme të inteligjencës, në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Politika i kushton vëmendje të veçantë parandalimit dhe ndërtimit të qëndrueshmërisë institucionale dhe shoqërore, përmes forcimit të kapaciteteve të institucioneve publike, sigurimit të komunikimeve, bashkëpunimit me platformat digjitale dhe zhvillimit të iniciativave për edukimin mediatik dhe digjital. Në rast të materializimit të kërcënimeve, politika parashikon reagim të koordinuar dhe menaxhim efektiv të krizave, përmes protokolleve të qarta operationale, komunikimit strategjik dhe përdorimit të mekanizmave ligjorë dhe diplomatikë. Procesi përmbyllet me masa për rimëkëmbjen dhe rikthimin e besimit publik, duke garantuar transparencë pas incidenteve, mësim të nxjerra dhe përmirësim të vazhdueshëm institucional.

6. Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar përbën një element tjetër me rëndësi për këtë politikë, duke reflektuar natyrën ndërkufitare dhe komplekse të kërcënimeve hibride. Politika parashikon pjesëmarrjen aktive të Republikës së Shqipërisë, përmes AKSK-së, në mekanizmat dhe strukturat ndërkombëtare të dedikuara për kundërveprimin ndaj kërcënimeve hibride, përfshirë angazhimin në Qendrën Evropiane të Ekselencës për Kundërveprimin ndaj Kërcënimeve Hibride (Hybrid CoE). Ky angazhim synon rritjen e ndërveprimit, shkëmbimin e analizave strategjike, pjesëmarrjen në ushtrime dhe ndërtimin e kapaciteteve të përbashkëta.

Politika siguron gjithashtu integrimin e plotë me mekanizmat dhe instrumentet e Bashkimit Evropian, përfshirë Direktivën NIS2, Aktin për Shërbimet Digjitale (DSA) dhe EU Hybrid Toolbox, duke garantuar koherencë ndërmjet politikave kombëtare dhe kuadrit rregullator evropian. Në të njëjtën kohë, veprimet e parashikuara harmonizohen me kornizat e NATO-s për kërcënimet hibride dhe qëndrueshmërinë shoqërore, duke forcuar bashkëpunimin euroatlantik dhe kontributin e Shqipërisë në sigurinë kolektive.

Në këtë kuadër, politika nxit zhvillimin e partneriteteve bilaterale dhe multilaterale me shtete partnere, organizata ndërkombëtare dhe institucione homologe, me qëllim shkëmbimin e informacionit, koordinimin operacional dhe realizimin e nismave të përbashkëta në fushën e parandalimit dhe reagimit ndaj kërcënimeve hibride.

7. Zhvillimi Ligjor dhe Mbikëqyrja

Zhvillimi dhe përditësimi i kuadrit ligjor përbën një shtyllë të rëndësishme për zbatimin efektiv të kësaj politike. Kjo politikë synon adresimin e boshllëqeve ligjore që lidhen me ndërhyrjet e huaja të paligjshme, operacionet e dezinformimit dhe format e tjera të kërcënimeve hibride, duke garantuar një qasje parandaluese, proporcionale dhe në përputhje me standardet evropiane.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet rritjes së transparencës në fushën e reklamave politike dhe financimit të aktiviteteve të ndikimit, si dhe forcimit të mekanizmave të bashkëpunimit me platformat digjitale në situata të identifikuar si kërcënime hibride. Këto masa synojnë rritjen e përgjegjshmërisë dhe parandalimin e manipulimit të hapësirës informative, pa çënuar lirinë e shprehjes dhe pluralizmin mediatic.

Mbikëqyrja demokratike dhe institucionale sigurohet përmes rolit të Parlamentit dhe mekanizmave të auditimit/ kontrollit të pavarur, të cilët garantojnë transparencë, llogaridhënie dhe respektim të të drejtave themelore gjatë zbatimit të politikës.

8. Zbatimi dhe Afatet (2025–2030)

Zbatimi i politikës parashikohet të realizohet në disa faza përgjatë periudhës 2025–2030, duke reflektuar një qasje progresive dhe të qëndrueshme. Faza e parë, që mbulon periudhën 2025–2026, fokusohet në ndërtimin dhe konsolidimin institucional, si dhe në përputhjen e kuadrit ligjor dhe rregullator me kërkesat e reja që burojnë nga kërcënimet hibride.

Faza e dytë, për periudhën 2027–2028, synon zhvillimin e kapaciteteve të avancuara analitike, forcimin e mekanizmave të koordinimit ndërkombëtar dhe integrimin më të thellë në strukturat dhe iniciativat evropiane dhe euroatlantike. Kjo fazë përqendrohet në rritjen e gatishmërisë operacionale dhe përmirësimin e ndërveprimit institucional.

Faza e tretë, që shtrihet në periudhën 2029–2030, ka si objektiv arritjen kapacitetit të plotë operacional dhe konsolidimin e rolit të Shqipërisë si kontribuese aktive dhe lidere rajonale në adresimin e kërcënimeve hibride, duke siguruar që mekanizmat e ndërtuar të jenë të qëndrueshëm dhe të aftë për t'u përshtatur me zhvillimet e ardhshme.

9. Referencat

Kjo politikë mbështetet në Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030, në legjislacionin kombëtar për sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe në politikat, standardet dhe instrumentet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe NATO-s për adresimin e kërcënimeve hibride dhe forcimin e qëndrueshmërisë demokratike.

10. Frekuenca e Rishikimit

Kjo politikë rishikohet periodikisht, të paktën një herë në dy vjet, ose më herët në rast se evidentohen ndryshime të rëndësishme në mjedisin e kërcënimeve, në kuadrin ligjor apo në arkitekturën institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare. Rishikimi synon të sigurojë përditësimin e vazhdueshëm të objektivave dhe masave, në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe strategjike.